



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 Nr. 400/01-14258/23
Kaçanik, 30.06.2023

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008) të Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/03 Qershor 2008) të Ligjit nr.03/L-221- Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 15 dhe 16 të Ligjit Nr.Nr.08/L-193 – Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 38/30 Dhjetor 2022), të nenit 61 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 qershor 2023, mori këtë:

V E N D I M
PËR TRANSFERIN E MJETEVE NGA REZERVA KOMUNALE
SIPAS BUXHETIT TË VITIT 2023

I. Me këtë Vendim, bëhet transferi i mjeteve nga Rezerva Komunale në kategorinë e investimeve kapitale në shumën e përgjithshme prej **120,000.00** euro, sipas tabelës të Ligjit të Buxhetit Nr.08/L-193 për vitin 2023, si në vijim:

I. Transferet-fondi 10 (Granti Qeveritar)

1.1. Nga Nën-Programi Buxhetor – Buxhetimi 17528 kodi funksional 0112 nga Rezerva komunale, fondi burimorë 10 GQ, shuma prej 10,000.00 €

→ **Transferohet:** Në Nën-Programin Buxhetor – Planifikimi urban dhe inspeksioni 66445 kodi funksional 0620 në kategorinë Shpenzimet Kapitale, në projektin kapital “Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën rurale-Kaçanik me kod projekti 53198, shuma 10,000.00€.

1.2. Nga Nën-Programi Buxhetor – Administrata 92140 kodi funksional 0980 nga Rezerva komunale, fondi burimorë 10 GQ, shuma prej 20,000.00 €

→ **Transferohet:** Në Nën-Programin Buxhetor – Arsimi fillor, i mesëm i ulët 93810 kodi funksional 0912 në kategorinë Shpenzimet Kapitale, në projektin kapital “Ndërtimi i kulmit të Shkollës Fillore “Qamil Ilazi” në Kaçanik të Vjetër, shuma prej 20,000.00€, projekt i ri.

1.3. Nga Nën-Programi Buxhetor – Shërbimet e shëndetësisë primare 74700 kodi funksional 0721 nga Rezerva komunale, fondi burimorë 10 GQ, shuma prej 50,000.00 €

→ **Transferohet:** Në Nën-Programin Buxhetor – Shërbimet e shëndetësisë primare 74700 kodi funksional 0721 në kategorinë Shpenzimet Kapitale, në projektin kapital “Blerja e automjetit (kombi) për hemodializë”, shuma prej 50,000.00€, projekt i ri.

2. Transferet-fondi 21 (Të hyrat vetanake)

2.1. Nga Nën-Programi Buxhetor – Administrata dhe Personeli 16328 kodi funksional 0133 nga Rezerva komunale, fondi burimorë 21 (HVK), shuma prej 5,000.00 €

→ **Transferohet:** Në Nën-Programin Buxhetor – Administrata dhe Personeli 16328 kodi funksional 0133, në kategorinë Shpenzimet Kapitale, ne projektin kapital “Ndertimi i parkingut nentokësorë për Administratës komunale” me kod 50995, shuma 5,000.00€

2.2. Nga Nën-Programi Buxhetor – Buxhetimi 17528 kodi funksional 0112 nga Rezerva komunale, fondi burimorë 21 (HVK), shuma prej 20,000.00 €

→ **Transferohet:** Në Nën-Programin Buxhetor – Planifikimi urban dhe inspeksioni 66445 kodi funksional 0620 në kategorinë Shpenzimet Kapitale, ne projektin kapital “Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën rurale-Kaçanik me kod projekti 53198, shuma 20,000.00€.

2.3. Nga Nën-Programi Buxhetor – Shërbimet Kulturore 85028 kodi funksional 0820 nga Rezerva komunale, fondi burimorë 21 (HVK), shuma prej 5,000.00 €

→ **Transferohet:** Në Nën-Programin Buxhetor – Shërbimet Kulturore 85028 kodi funksional 0820, në kategorinë Shpenzimet Kapitale, ne projektin kapital “Ndertimi i stadiumit te qytetit “Besnik Begunca” me kod 45064, shuma 5,000.00 €

2.4. Nga Nën-Programi Buxhetor – Administrata 92140 kodi funksional 0980 nga Rezerva komunale, fondi burimorë 21 (HVK), shuma prej 10,000.00 €

→ **Transferohet:** Në Nën-Programin Buxhetor – Arsimi fillor, i mesëm i ulët, kodi funksional 0912 në kategorinë Shpenzimet Kapitale, ne projektin kapital “Ndërtimi i kulmit të Shkollës Fillore “Qamil Ilazi” në Kaçanik të Vjetër, shuma prej 10,000.00€ projekt i ri.

II. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë, Formularet standard nga MFPT, të plotesuara me shumat e lëvizura sipas Nën-Programeve buxhetore dhe kodeve ekonomike të shpenzimeve.

III. Për realizimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njejtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave Transfereve dhe Punës, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.

IV. Me marrjen e këtij Vendimi, SHFUQIZOHET Vendimi 01Nr. 400/03-9058/23 i datës 28.04.2023 - për transferin e mjeteve nga rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2023.

V. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante);
3. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Murseli

